

## PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 3 NËNTOR 2025.

### NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC.

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek Komuna Bulgarec.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltar Elvin Bregu, Këshilltar Altin Habip, Këshilltare Gurije Dedelli Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale.

Këshilltar P.Tollkuçi: Përshëndetje të gjithëve, jemi mbledhur këtu për të ridëgjuar edhe njëherë ato problematike që i keni shprehur kryetarit t'i ridëgjojmë edhe ne si Këshill.

Këshilltar E.Bregu: Përshëndetje të gjithëve, ne jemi këtu për të dëgjuar problematikat tuaja kryesore dhe për të bërë më të mirën për ju në miratimin e buxhetit.

Këshilltar A.Habip: Edhe unë ju falenderoj që jeni prezent, do donim të dëgjonim prej jush problematikat më kryesore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po e nis me Bulgarecin.

#### **Fshati Bulgarec.**

- Asfaltimi i rrugës të Xhamisë dhe Smt.
- Sistemimi i trotuareve të rrugës të fshatit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtoria e Urbanistikës po përgatit një projekt për këtë, kjo mund të bëhet edhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

- Ndërtimi i palestrës.
- Rregullimi i rrugës të "Sadikut".

Banori: Rruga hyrëse është e ngushtë dhe duhet një pjesë trotuar, të spostohet kanali.

#### **Fshati Çiflig.**

- Shtrimi i rrugës të Manastirit. (Kryetari u shpreh se ishte i gatshëm për ta shtruar).
- Rikonstruksioni i Muzeut.

Banori: Muzeu po bie fare është i rrezikshëm.

Këshilltar E.Bregu: Klajdi si administrator mund ta kërkojë.

Administratori: Është në inventarin e Bashkisë por është e vërtetë rrezikon të shembet.

Këshilltar E.Bregu: Pasi bën kërkesën, Kryetari i Bashkisë ngre një grup pune dhe bën investigimin.

Banori: Është emergjente, gjithashtu edhe energjia është problem.

#### **Fshati Belorta.**

- Asfaltimi i një rruge pasi është lënë përgjysëm.

Kryetari i Fshatit Belorta: Është e domosdoshme pjesa poshtë e rrugës, gjithashtu edhe ujërat e zeza janë problem pasi hyjnë nëpër shkolla, gjithashtu nëpër fshatra ka dhe shumë avlli të vjetra ku duhet të ndërhyri, duhet ngritur një grup pune të kontrollojë punët në fshat.

#### **Fshati Malavec.**

- Rikonstruksioni i asfaltit.

Kryetari i Fshatit Malavec: Rruga që tek Xhamia dhe deri në qendër është me asfalt por është e amortizuar. Në varrezat nuk është bërë asnjë investim, duhen bordure tek varret.

#### **Fshati Lumalas.**

- Asfaltimi i rrugës të fshatit.

Kryetari i Fshatit Lumalas: Rruga brenda fshatit duhet bërë dhe rruga që lidhet me Melçanin. Shtëpitë janë mbushur me inerte nga gurorja prandaj duhet bërë asfaltimi i rrugës që kur bie shi inertet mos vijnë tek shtëpitë tona.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: I japim zgjidhje asfaltimit të rrugës kryesore njëherë, rruga që lidh Melçanin me Lumalasin ta lemë për buxhetin e vitit tjetër.

#### **Fshati Melçan.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fshati Melçan ka kërkuar dy gjëra që për mendimin tim nuk kërkojnë buxhet por janë punë të Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike dhe duhen ndjekur nga Klajdi.

Banor: Këshilli i Bashkisë ka miratuar një ligj që stallat duhet të jenë jashtë fshatit, tani dikush nga fshati ka ndërtuar stallën ngjitur me fshatin dhe ka shumë ankesa.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është kërkuar me ligj por asnjërit nuk i jepej leje të ndërtohej stalla, tani mund të ndërtohet edhe pa leje, kjo është diçka që nuk kërkon investim, duhet të merret Klajdi dhe ta ndjekë.

#### **Fshati Dishnicë.**

- Ndriçues publik anësorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është detyrë e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike.

- Asfaltimi i rrugës poshtë.

Banori: Kjo rrugë duhet të ishte bërë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do e futim me buxhetin e këtij viti.

#### **Fshati Barç.**

Këshilltare G.Dedelli: Duke ditur kërkesat e komunitetit, duan asfaltimin e rrugëve të brendshme.

#### **Fshati Kuç i Zi.**

Kryetari i Fshatit Fshatit Kuç i Zi: Kur ra breshëri ju na thatë se fermerët do i shpërblente Qeveria në lidhje me dëmet. Dua të di edhe nëse ka të bëjë Këshilli me ngritjen e tarifës të ujit të pijshëm, me vlerësimin e taksave, pasi është rritur me 30 lekë dhe banorët janë të pa kënaqur. Gjithashtu asfalti deri tek shkolla duhet bërë. Telat e energjisë elektrike janë shumë të rrezikshëm. Në lidhje me ujin jemi fshati i parë për taksapagues më të mirë, na duhet edhe ujë tek varret. Kam kërkuar 20 rrënjë blir për t'i mbjellë tek shkolla, gjithashtu problematikë shumë e madhe janë prerja e druve duhet ndalur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne jemi për investim këtu, tarifat e ujit janë pjesë e Ndërmarrjes të Ujësjetës Kanalizimive duhet të ankoheni atje, megjithatë ndërmarrja i rriti tarifat për një shërbim më të mirë.

Këshilltar E.Bregu: Në takimin e sotëm mund të vinin edhe banorë të shprehnin vetë problematikat.

Kryeplaku i Fshatit Kuç i Zi: Varrezat janë të mira por janë falë banorëve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është detyrë e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike kjo.

Kryetari i Fshatit Kuç i Zi: Duhet të rriten dhe rrogat e kryetarëve të fshatrave.

Kryetar i Fshatit Lumalas: Në fshatin tonë duhen edhe disa kosha.

Administratori: Janë vendosur dy kosha të rinj.

Kryetari i Fshatit Lumalas: Mendoj se duhet folur me arsimin për tu zhvilluar një orë ndërgjegjësimi për të mësuar të rinjtë sesi duhet mirëmbajtur pastër komuniteti.

Këshilltar E.Bregu: Rritja e taksave lokale u bë vjet me një % të caktuar, një pjesë kishin logjikë, një pjesë jo dhe nuk na u dha argumenti. Tarifat e ujit u rritën sepse fillimisht u bashkuan të gjithë ujësjetësat e qarkut, më pas do bashkohen me gjithë Shqipërinë. Tarifa e ujit është e pa argumentuar edhe unë e kam kërkuar ta sjellin dhe nuk e kanë sjellë ende.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ujësjetësi ka sjellë investimet dhe shërbimet e kryera dhe rezulton se ai ka bërë investime. Në fshat banorët janë mësuar të paguajnë pak dhe prandaj bëhet krahasimi tani, por këto janë kushtet.

#### **Fshati Biranj.**

Kryetari i Fshatit Biranj: Shtrimi i rrugës të varrezave dhe lagjia e re nuk është prekur fare nga investimet me asfalt, pjesa e asfaltit të bërë nuk ka beton anësor. Gjithashtu dhe ujërat e zeza janë problem i madh.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë ju falenderoj që na dëgjuat por edhe ju dëgjuam, të jeni të bindur që ne do kemi ndjeshmëri për problemet tuaja dhe të gjitha shqetësimet tuaja do adresohen.

FOTO



# PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 4 NËNTOR 2025.

## RAJONI 1, 2 DHE 3.

Ora e hapjes së takimit : 18:00.

Zhvillimi i takimit: Tek Bibloteka.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltar Llamberto Malaveci, Këshilltare Edlira Mitre, Këshilltar Altin Habip, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratorët e rajoneve dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëmbërëma të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim dhe janë në të mirën e përbashkët të komunitetit. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale.

Këshilltar P.Tollkuçi: Faleminderit që jeni prezent, ne si Këshill po bëjmë për herë të parë këto konsultime, ne do këmbëngulim sipas rajoneve problematikat kryesore të futen në buxhet. Ju ftoj të ndiheni të lirë për të folur.

### **Rajoni 2.**

Administratori i Rajonit 2: Përshëndetje të gjithëve, rruga "Nexhip Vinçani" dhe rrugët e lagjeve 14,15,16, rruga "Spiro Kondo" duhen bërë kanalizimet dhe asfaltimet. Rruga "Nexhip Vinçani" janë disa gazerma të cilat ose duhet të prishen ose tu jepet zgjidhje, gjithashtu duhen bërë edhe kanalizimet në lagjen 16.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne po i mbajmë shënim edhe po i adresojmë.

Banor: Ne kemi një problem prej shumë vitesh, tek pallati jonë lagështia ka marrë muret duhet bërë një përtharje dhe pastaj të merren masa të tjera, korridoret janë të çara nga tërmeti.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të kishim ndonjë përfaqësues nga Drejtoria e Urbanistikës nëse janë në dijeni apo jo të problemit, do fillojë veshja me kapot për pallatet.

Banor: Ata kanë erdhur.

Banor: Unë jam banor i lagjes 15, banjo në katin e 4 të një palati dhe komshiu tek kati i 5 ka ndëruar jetë dhe mua më pikon shtëpia, më është thënë se do jepej zgjidhje pas zgjedhjeve por ende nuk është bërë asgjë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të takoni drejtorin e urbanistikës, ne duam të dëgjojmë nevojat tuaja të cilat kërkojnë buxhet për të investuar, këto nuk i zgjidhim dot.

Administratori: Janë dy opsione të ndihmojmë shtresat në nevojë dhe pjesa e dytë ku banori bashkëfinancon 50 % ku ble materialet, ne nuk mund të bëjmë asgjë, unë kam vajtur kam bërë matjet por nuk e ndihmoj dot.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të flasim për problematika madhore, jo gjëra personale.

Banor: Duhet një administrator pallati, gjithashtu edhe qentë janë shumë problem tu jepet zgjidhje.

Këshilltar A.Habip: Tek lagjia 15 nuk ka 1 qëndër apartive, ndoshta duhet folur me Drejtorinë Arsimore pasi tek shkolla "Gjuhët e Huaja" ka një ambient të mbyllur.

Banor: Duhet rregulluar spitali pasi muret mbrapa spitalit ka të shkrojtura, suvaja e spitalit ka rënë. Tek Fabrika e birrës lart gjithë mbeturinat janë në trotuare, gjithashtu nuk ka as ndriçim. Tek lagjia 4 duhet një qëndër për pensionistët..

Banor: Lagjia 16 nuk është asfaltuar asnjë rrugë, kanalizimet janë bërë në dy rrugë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Kjo e qëndrës për pensionistë tek lagjia 4 duhet pasi është e vërtet nuk ka.

### **Rajoni 3.**

Administratori i Rajonit 3: Përshëndetje, tek lagjia 6 kanë probleme me asfaltimet, rruga e Ersekës deri tek Shkolla Greke nuk ka ndriçim. Gjithashtu tek lagjia 6 është problem Tregu i Shuleve, Bashkia duhet ta spostojë atë treg. Lagjia 8 nuk janë bërë kanalizimet dhe nuk ka ndriçim. Duhet një qëndër për moshën e 3 dhe tek lagjet 9 dhe 18 janë të mbipopulluara duhet një çerdhe publike

### **Rajoni 1.**

Administratori i Rajonit 1: Përshëndetje, problematikë kryesore është pjesa e termoizolimit sepse është bërë vetëm një pjesë e pallateve. Për pjesën e rrugëve rajoni 1 përfshin rrugë historike me kalldrëm dhe me ndërtimin e këtyre pallateve 3 katëshe është prishur kalldrëmi, subjektet që e prishin bëjnë një pagesë por pas 1 periudhe bien sërish. Lagjia 1, "Viktor Xhika" kemi problem sistemin e njerëzve që jetojnë në baranga, ka mbi 30 familje.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka punojësit që pas ndërtimeve i rregullon. Në lidhje me termoizolimin është dhe pjesa e bashkëfinancimit 50 %.

Banor: Është kosto e lartë.

Banor: Palalti 5-katësh tek shkolla "Nuçi Naçi", banorët i kanë blerë materialet duhet bërë.

Alfons Vranishti: Lagjia 10, tek Enti i Banesave pjesa para pallateve është e pashtruar, ka baltë dhe atje është një kopësht dhe prindërit i marrin fëmijët në krahë pasi ka gropa, ka 7 vjet si problematikë.

Administratori: Atje po ndërtohen pallate të tjera, gjithashtu nuk ka as ndriçim.

Banor: Unaza ka problem sinjalistikën rrugore nuk ka as vija të bardha.

Administratori: Rruga "Jorgo Plaku" është një pjesë me shkallë duhet bërë me beton.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të flasni me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ne si këshilltarë të gjitha këto do ja parashatrojmë ekzekutivit për projektbuxhetin e vitit 2026 dhe do ndjekim edhe pjesën e realizimit. Ka disa problematika në rajoni 2 problemet me rrugët

do vendosim ato të cilat janë më primare. Bashkia tek njësitë administrative ka ngritur një grup punojësish për të kontrolluar punët e njëjta gjë do bëhet edhe me qytetin.

Banor: Vendet ku u liruan hapësirat publike duhen sistemuar pasi kanë ngelur shumë keq, sidomos lagjia 13 përballë Xhamisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju falenderojmë të gjithëve për pjesëmarrjen dhe mendimet tuaja, ne do jemi gjithmonë pranë jush dhe do ja përcjellim ekzekutivit gjitha problemet tuaja.

#### FOTO



# PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 28 TETOR 2025.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ.

Ora e hapjes së takimit : 17:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Mollaj.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltare Majlinda Like, Këshilltar Altin Habip, Këshilltare Ada Përmeti, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale. Ju keni bërë disa kërkesa por unë po lexoj vetëm ato që duan investim nga ana jonë.

### **Fshati Dvoran.**

- Sistemimi i lumit dhe restaurimi i pallateve dy-katëshe.

### **Fshati Floq.**

- Asfaltimi i rrugës kryesore dhe sistemi i rrugës të Kishës.

### **Fshati Kamenicë.**

- Shtrimi me stabilizant i rrugës të varrezave.
- Vendorsja e ndriçuesve.
- Vendorsja e dy portave tek lumi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse ka diçka tjetër të pa thënë tek takimet dhe ta pasqyrojmë tek buxheti i 2026 të vendosim më primaret.

Banori: Ne mjafton të na bëhet 1 në vit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse dikush mungon sot Majlinda është këshilltare dhe mund t'ja adresoni asaj.

Këshilltare A.Përmeti: Ka disa nevoja që kryhen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe çfarë mund të bëjë Bashkia me fondet e saj dhe donatorë. Problematika e rrugëve ato të cilat janë të nevojshme duhet të bëhen me projekt.

Kryetari i Fshatit Dvoran: Në fshatin Dvoran është premtuar argjinatura e lumit, por ka një problem që nuk u shkohet deri në fund punëve. Është bërë pastrimi i lumit por jo sistemimi sepse në rast se del nga diga përmbyt gjithë Dvoranin. Ai lumë do 3-4 pruta që nga lumi deri në Voskopojë dhe zgjidhet problem. Rruga Dvoran-Boboshticë duhet asfaltim i rrugës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një pjesë e tyre duhet kryer me donatorë por do ja përcjellim Bashkisë.

Banori: Stacioni i deles ka përfunduar shumë keq.

Këshilltare A.Përmeti: Ju sjell ndonjë dobi?

Kryetari i Fshatit Dvoran: Jo nuk ka lidhje. Në lidhje me taksat kam një mendimkur Këshilli miratoin taksat pasi ishte problem rritja e taksës të ujit.

Këshilltare A.Përmeti: Në lidhje me këtë problem duhet t'i drejtoheni Drejtorisë së Ujësjellësit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ato rriten me VKM nëse keni paqartësi drejtoheni Drejtorisë së Ujësjellësit por ato rriten në bazë të investimeve dhe shërbimeve.

Banori: Dvorani u përfshi në rritjen e taksave pse duhet të rriten sërish?

Këshilltare A.Përmeti: Bëni kërkesa tek faqja e ujësjellësit.

Kryetari i Fshatit Dvoran: Në Dvoran duhet menduar një ambient për moshën e 3 pasi ka shumë pensionista, gjithashtu një rrugë sipër fshatit Dvoran është e vështrië të kalosh duhet çakullimi dhe menaxhimi i kanaleve anësore. Kanalizimi i ujërvaë të zeza nuk është bërë tek një lagje.

Këshilltare A.Përmeti: Është pjesë e ujësjellësit jo tona.

Kryetari i Fshatit Dvoran: Duhet bërë dhe rrethim i varrezave dhe kemi nevojë për shtim të tokës për varreza.

Këshilltare A.Përmeti: Duhet bërë rivelimin më pas kërkesë për shpronësim pasi shteti duhet të dalë me dokumenta përkatëse.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në lidhje me Floqin problematikë është asfaltimi i rrugës të Kishës. Ne i mbajtmë shënim dhe do bëjmë të pamundurën për këto kërkesa primare që keni shprehur.

Banori: Lumin e kanë lënë rrëmujë, ka gurë gjithashtu kemi dhe ankesë për kanalizimet e ujërave të zeza.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk është detyrë e jona e thashë edhe njëherë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Unë jam dakort me Altinin nuk dueht të premtojmë shumë gjëra por të them nga 1 gjë për çdo fshat dhe qytetarët dhe banorët e fshatrave kanë shumë të drejtë si taksapagues të bëjnë kërkesa por duhet të zgjedhin primaret pasi të gjitha nuk i plotësojmë sot.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Banorët e fshatit kanë nevojë për një qëndër për moshën e 3 dhe Këshilli i Qarkut të llogarisë buxhet për një qëndër me mjedis të brendshëm .

Këshilltar P.Tollkuçi: Këshilli i Qarkut ka aplikuar mesa di unë pasi unë tani e mora postin, ka aplikuar tek fondi social në Ministri do flas në lidhje me këtë pjesë pasi nuk e di tamam, por kemi një problematikë në lidhje me pensionistët e vetmuar.

Këshilltare A.Përmeti: Nëse Bashkia e fut projektin vetë, vitin tjetër hyn tek Këshilli i Qarkut.

Banori: Kemi folur me Kryetarin dhe na ka premtuar se do flasë edhe me Këshillin e Qarkut.

Këshilltari A.Përmeti: Në lidhje me problematikat që thatë për kanalizimet apo ujin, problematikat që keni me SHA-të ne si bashki nuk mund të bëjmë asgjë duhet të bëni kërkesë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit të gjithëve që ishit prezent ne do i adresojmë problematikat tuaja tek ekzekutivi dhe do jemi zëri juaj.

**Foto**



# PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 28 TETOR 2025.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE VITHKUQ.

Ora e hapjes së takimit : 15:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Vithkuq.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, Nënkyetar Kletjon Kita, Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltare Majlinda Duni, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim.

Këshilltar P.Tollkuçi: Duam të dimë nga ju nevojat më të rëndësishme për t'i pasqyruar në projektbuxheti i vitit 2026 dhe t'i vendosim disa "kushte" Bashkisë për t'i plotësuar këto nevoja dhe për të bërë më të mirën në buxhetin e 2026.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala është për ju.

### **Fshati Lubonjë.**

Kryetari i Fshatit Lubonjë: Investimi i parë i fshatit është lumi të cilin kanë lënë përgjysëm.

Rikonstruksioni i një pjese të rrugës dhe probleme me ujësjellës kanalizimet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kë doni ju primare të vendosim në buxhet?

Kryetari i Fshatit Lubonjë: Problemi kryesor është ujësjellësi, gjithashtu dhe asfaltimi i rrugës afërisht 1 km por edhe pjesa e lumit është problem pasi është lënë përgjysëm.

Ekzekutivi: Ujësjellësin e kanë ndarë nga fshati dhe kanë bërë kërkesën për ta bashkuar me qytetin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo duhet adresuar tek Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve nuk është detyra jonë.

- Tjegullat e Kishës janë dëmtuar duhet të zvendësohen.

### **Fshati Rehovë.**

Kryetari i Fshatit Rehovë: Fshati Rehovë ka nevojë për çakullimin e rrugëve dhe kanalet anësore të kullimit.

### **Fshati VITHKUQ.**

Kryetari i Fshatit Vithkuq: Rrugët e brendshme janë copë, uji i pijshëm dhe dritat janë prioritare.

Ekzekutivi: Kanë filluar po bëhen investime, në bazë të probelamtikës u zgjodhën dy rrugë në fshatin Vithkuq si prioritare. Më shumë problematikë ishte Lagjia e “Dukasit” dhe më pak ajo e “Saraçit”.

Kryetari i Fshatit Vithkuq: Makina e plehrave duhet të hyjë deri në fshat.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Këto janë probleme rutinë që duhen udhëhequr nga kryetari i fshatit. Për fshatin Vithkuq nuk na është kërkuar asnjë investim, unë kam marrë porosi nga Kryetari i Bashkisë të bëjmë sistemime tek të gjitha fshatrat me materialet që kemi. Për punën e dritave unë di që OSHE e ka shtrirë kabllin.

Banori: Në lidhje me investimet duam rregullimin e kalldrëmëve dhe rikonstrukcionin e qëndrave sportive. Uji është primar, duhet të bëhet sistemim i saktë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Investimi i bërë në Mollaj dhe Kamenicë në lidhje me ujësjellësin është super investim normale kundrejt pagesës.

Kryetari i Fshatit Vithkuq: Ujësjellësi i Vithkuqit duhet të jetë prioritet i Bashkisë pasi Vithkuqi si fshat ofron gjithë ato atraksione turistike.

Ekzekutivi: Dhe pjesa e rrugës të “Voskopojës” duhet kërkuar të rikonstruktohet.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Në lidhje me festën do bëjmë të pamundur që ta bëjmë të përvitshme, për kohën e vendosim vetë por duhet ta vendosim në kalendarin e festave.

Kryetari i Fshatit Vithkuq: Përsa i përket ujësjellësit pjesa e hekurit është ndryshk dhe është shqetësuese dhe gjithashtu përshembull ka difekt fshati Lekas ikin dhe dritat këtu.

Ekzekutivi: Kam folur me OSHE dhe është detyra e saj jo e Bashkisë duhet të jeni bashkëpunues me ta.

Këshilltar P.Tollkuçi: Në lidhje me fondet e 2026 nuk e di sa është e mundur ta realizojë OSHE por do e përcjellim si shqetësim.

Kryetari i Fshatit Vithkuq: Duhet shkëputur nga linja kryesore vetëm kështu zgjidhet si shqetësim.

Ekzekutivi: Në lidhje me shkëputjen kam folur me drejtorinë dhe nuk ka zgjidhje. Në lidhje me fshatin Panarit kanë problem kryesor rrugën kryesore dhe kanalizimet.

### **Fshati Shtyllë**

- Pastrimin e lumit dhe mbrojtës anësor.

### **Fshati Leshnjë**

- Asfaltimi i rrugës të varrezave, vendosja e 4 koshave dhe 4 ndriçues dhe hapja e shtratit të lumit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vendosja e 4 koshave dhe 4 ndriçuesve është diçka që bëhet do ja adresojmë Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike.

Banori: Duhet edhe kanal vaditës.

Ekzekutivi: Këto nuk janë investime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në lidhje me taksat po të keni diçka kemi dy përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore mund t’i pyesni.

Banori: Është dyfishuar çmimi i ujit.

Ekzekutivi: Uji është i të gjithëve, nëse doni ujësjellës bëni kërkesë drejtorisë së ujësjellësit për tu futur tek ai i Korçës.

Administrator Altini: Kemi nevojë për një eskavator të mirë, ta kemi në përdorim të njësisë.

Ekzekutivi: Kjo është detyrë e Ndërmarrjes Të Shërbimeve Publike, nuk mund të jetë vetëm në përdorim të njësisë tuaj.

### **Fshati Lubonjë**

- Duhet bërë rruga kryesore.

Këshilltar P.Tollkuçi: Në lidhje me këtë rrugë, kryetari po bën të pamundurën.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse keni diçka tjetër Majlinda është këshilltare dhe mund t'i thoni asaj para se të miratojmë bxuhetin nëse harruat për të thënë diçka tjetër sot, ne jemi pranë jush do sigurohemi t'i adresojmë të gjitha problematikat tuaja. Faleminderit që ishit prezent.

### **FOTO**



## PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 29 TETOR 2025.

### NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË-LEKAS.

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Voskopojë.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltar Kostika Zguri, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale. Ju keni bërë disa kërkesa por unë po lexoj vetëm ato që duan investim nga ana jonë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Unë jam anëtar i Këshillit Bashkiak Korçë dhe kryetar i komisionit të financave, në momentin e miratimit të projektbuxhetit 2026 duhet të jemi të bindur që të kemi vendosur kërkesat tuaja primare, ne si Këshill duhet të dalim garant që kërkesat tuaja të jenë pasqyruar, banorët si taksapagues kërkojnë më të mirën dhe me të drejtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne këtu jemi për të evidentuar problematikat që kërkojnë buxhet disa prej jush kanë dalë jashtë teme duke listuar probleme me lejet e ndërtimit, nuk merremi ne me këtë pjesë ne duam nga ju mendimet tuaja për investime për nevojat primare. Po listoj disa nga probleme që unë mendoj se kërkojnë buxhet.

#### **Fshati Voskopojë.**

- 23-24 Qershor aktivitete për çeljen e sezonit turistik.
- Rikonstruksioni i palestrës të shkollës.
- Vendsoja e disa koshave.
- Probleme me ngrohjen e shkollës.

#### **Fshati Lekas.**

- Rruga e fshatit ka nevojë për asfaltim.

#### **Fshati Lavdar.**

- Krijimi i një qendre shëndetësore.
- Fadromë për hapje kanalesh.
- Asfaltimi i rrugës të fshatit.

#### **Fshati Gjonmadh.**

- Asfaltimi i rrugës.

## **Fsahti Lekas.**

- Kërkesë për ndriçues publik.
- Fillimi i punimeve për rrugën e “Denasit”.
- Ndërhyrje në përoi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këto janë kërkesa që për mua kërkojnë buxhet në investim.

Kryetari i Fshatit Voskopojë: Problem kryesor janë pronat, po zvarriten shumë pasi njerëzit kanë paguar taksat dhe nuk po marrin asgjë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këto Nuk i zgjidhim dot ne, ne jemi për gjëra që kërkojnë buxhet në investime.

Kryetari i Fshatit Voskopojë: Bashkia nuk ka dhënë ende çertifikatat e pronësisë dhe ne kemi probleme. Problem tjetër është banja publike, duhet një banjë publike në fshat pasi Voskopoja ka shumë turistë dhe nuk kanë ku shkojnë. Gjithashtu duhet një ndërhyrje për zgjerimin e sheshit..

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtoria e Urbanistikës po bën një projekt për rikompozimin e qëndrave të fshatit të çdo njësie dhe kjo do futet në funksion.

Kryetari i Fshatit Voskopojë: Duhet sistemuar dhe të bëhet një shesh vetëm për qëndrimin e autobusave. Problematikë tjetër duhet vend për stallë pasi toka ka, madje edhe me qera e marrim vetëm të kemi. Palestra e shkollës duhet rikonstruktuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë kam qënë pak skeptike në lidhje me rikonstruksionin e palestrës të shkollës pasi e prishin më vonë pasi është rikonstruktuar. Në Korçë tek një shkollë u krijua marëveshje midis shkollës dhe të rinjve që pas rikonstruksionit në rast se prishej diçka do paguaj nga të rinjtë që e frekuentonin, kjo është një zgjidhje që mund t’ju jap.

Kryetari i Fshatit Voskopojë: Edhe për mirëmbajtjejn e koshave duhet të kujdeset dikush. Uji i pijshëm është gjithashtu problem. Rrugët e parcelave duhet një rregullim. Këto janë primare.

Banor: Duhet investim për shtimin e sasisë të ujit të pijshëm dhe e dyta duhet një banjë publike, është një dhomë e lirë tek sheshi le ta përdorim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Baskia bën investime vetëm tek ato prona që i ka në pronësi.

Banor: Sheshi me pllaka duhet të ngushtohet dhe të rrijë sheshi që është.

Këshilltar K.Zguri: Ne si Këshill kemi funksion mbi pronat. Disa probleme të tjera do ngelen pa zgjidhje, ne rritëm tarifën e ujit por ujësjellësi duhet të mbajë përgjegjësi dhe ne duhet të sygjerojmë një fond për të mbuluar furnizimin me ujë, duhet zgjidhje afatgjatë. Ngrohja e shkollës nuk ka problem teknik por Voskopoja ka fashë orari dhe duhet të ndizet para se nxënësit të shkojnë në mësim. Për pjesën e palestrës kërkohet fond për rikonstruksion. Unë kam një sygjërim duhet një fond për zbukurimin e fshatit për festa pasi Voskopoja është i vetmi fshat që nuk ka asnjë aktivitet, minimalisht të jenë 3 festa.

Këshilltar P.Tollkuçi: Të bëjmë njëherë 23-24 qershorin që lidhet me “Shën Prodhoinin”.

Administratori: Unë kam menduar disa aktivitete. E para në 13 Mars kam menduar festë për ndezjen e zjarrit të Ditës të Verës. Festa e çeljes të sezonit turistik në 23 qershor dhe festa e majlit mund të bëhet midis Bashkisë apo ndonjë institucioni tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dua të bëj një pyetje, a ka bletërritës në fshat?

Në rast se ka ata mund të bëjnë festa shëtitëse me buxhet nga Bashki të ndryshme.

Administratori: Kam menduar të bëhet një dekorim i mirëfilltë, duhen bërë disa shtegje.

Kryetari i Fshatit Voskopojë: Duhet gjithashtu një pastrim pyjesh.

Këshilltar P.Tollkuçi: Mundt ë bëjmë një projekt sepse ka aparatura, kamera termike nëse ka zjarre por duhen parë buxhetet.

Administratori: Të bëhet kalldrëm deri tek Kisha "SHën Ilia".

Këshilltar K.Zguri: Tek rendi i ditës pashë që do vendoset një monument përkujtimor, duheshin bërë dëgjersa publike si fillim.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Kjo është kërkesë nga Ambasada Hungareze dhe nuk ka detyrim ligjor.

Kryetari i Fshatit Gjonmadh: Duam përfundimin e përoit që nisi këtë verë. Asfalti ka mbetur deri në hyrje të fshatit dhe nuk hyn asnjë makinë brenda fshatit. Kemi probleme edhe me elektrikun, gjithashtu duhet të shtohet edhe një kontrollues ujësjellësi sepse ankohen familjet.

Kryetari i Fshatit Lavdar: Rruga e fshatit është copë-copë duhet bërë. Në fshat mungon qendra shëndetësore këto të 2-ja janë primare. Duhet edhe ndonjë kopësht.

Administratori: Në mungesë të kryetarit të fshatit Shipskë duhet çakullimi i rrugës, vetëm kjo kërkesë është.

Banori i Lekasit: Problem është rruga automobilistike duhet asfaltuar, ka edhe dy vende të tjera ku duhet ndërhyrje. Fsahti Denas ka problem duhet të vihet një urë ushtarake. Rikosntruksioni i Kishës pasi është vepër e rrallë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne I mbajtmë shënim të gjitha problemet tuaja, të jeni të sigurt që do ja raportojmë ekzekutivit, do mbajmë një raport ku do paraqesim gjithë problemet tuaja primare. Faleminderit që ishit pjesë e këtij takimi.

#### FOTO.



# PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 29 TETOR 2025.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOP.

Ora e hapjes së takimit : 17:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Voskop.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltare Ada Përmeti, Këshilltar Altin Habip, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale. Te jemi pak më racionalë dhe të ndalemi vetëm tek investimet që kërkojnë buxhete.

### Fshati Voskop.

- Shtrimi i rrugës të vjetër.
- Shtrimi i rrugës të varrezave.
- Rregullimi i fsuhës të sportit.
- Ndiriçimi i rrugës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nga këto mund të plotësohen kë keni ju më primare.

Kryetari i Fshatit Voskop: Rruga gati 1 km është, është e pjerrët dhe kur bie shi na shkakton dëme.

Administratori: Kërkesa është e vazhdueshme në lidhje me fushën e sportit, duhet investuar.

Këshilltare A.Përmeti: Kjo duhet bërë me projekt nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës.

Banor: Qendra shëndetësore është shumë e vogël.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do ketë një program nga doantorë për rregullimin e të gjitha qendrat shëndetësore të fshatrave.

### Fshati Dërsnik.

- Probleme me keqberësit që dëmtojnë hapësirat publike.

### Fshati Vinçan.

- Vendosja e disa ndriçuesve dhe koshave të mbeturinave.

### Fshati Goskovë e Poshtme.

- Asfaltimi nga Lavdari, rruga që lidh Goskovën me Vinçanin.
- Në fushën e varrezave të shtrohet rruga, rregullimi i mureve rrethues.

- Probleme me kanalizimin, me kanalet vaditëse dhe probleme me ujin e pijshëm.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në lidhje me ujin e pijshëm, pusi ka prurje të furnizojë fshatin lart dhe fshati nuk donte të bashkëpunonte.

Banori: Atje është problem keqmenaxhimi i ujit, duhen futur sahatet në punë sepse atje ka ujë.

Këshilltare A.Përmeti: Duhet t'i futë ujësjellësi.

Banori: Investimi është bërë por duam degëzime me fshatin Goskovë Lart, gjithashtu nuk kemi rrymë elektrike.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të shkoni tek OSHE-ja ne nuk ju ndihmojmë dot.

Banori: Hiqeni linjën e vjetër.

#### **Fshati Polenë.**

- Rregullimi i qendrës të fshatit.

Banori: Kemi probleme edhe me ujin.

#### **Fshati Damjanec.**

- Rikonstrukcioni i urës të drurit.

Kryetari i Fshatit Dërsnik: Shumë faleminderit për dëgjuesën, me rrugën e fshatit Dërsnik na keni bërë diçka shumë të mirë, ju përgëzoj, por na duhet një zyrë për ne kryetarët e fshatrave pasi nuk kemi.

Këshilltare A.Përmeti: Në rast se keni godina bosh, Bashkia bën një projekt dhe e kthen në funksion të komunitetit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në lidhje me rregullimin e qendrës të fshatit Polenë është menduar një rikompozim i të gjitha qendrave të fshatit të çdo njësie administrative. Ju falenderoj për takimin, ne jemi të hapur t'ju ndihmojmë për çdo problem që keni.

#### **FOTO**



## PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 31 TETOR 2025.

### NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË.

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Drenovë.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetaria e Këshillit Ana Verushi, , Këshilltar Petrika Tollkuçi, Këshilltar Julian Mema, Sekretaria e Këshillit Eva Naçi, Përfqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të Pranishëm në takim: Administratori, kryetarët e fshatrave dhe banorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni erdhur në këtë takim, ne sot jemi mbledhur këtu për të marrë mendimet tuaja në lidhje me realizmin e buxhetit 2025 dhe për të dëgjuar nevojat tuaja primare për t'i pasqyruar tek projektbuxheti 2026. Nevojat mund të jenë të shumta por ju lutem të ndalemi tek ato më primaret, të cilat kërkojnë investim. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarive Vendore në rast se keni pyetje për paketën fiskale.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ne si Këshilli Bashkiak i Korçës në momentin e miratimit të projektbuxhetit 2026 duhet të jemi të bindur që të kemi vendosur kërkesat tuaja primare dhe të dalim garant që kërkesat tuaja të jenë pasqyruar, banorët si taksapagues kërkojnë më të mirën dhe me të drejtë. Çdo vit është bërë nga një gjë për fshatin tuaj. Unë, Altini dhe Ada jemi anëtar të komisionit të financave dhe duam të futim në buxhet problematikat tuaja kryesore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po lexoj problematikat që unë mendoj se duan buxhet.

#### **Fshati Mborje.**

- Kërkesë për përfundimin e rrugëve me kalldrëm të lëna përgjysëm.
- Rikonstruksioni i çezmës të fshatit.
- Asfaltimi i rrugës nga Lapidari deri tek Kisha e "Ristožit".
- Pastrimi i fshatit nga mbeturinat sepse makina vjen 1-2 herë në javë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo është punë e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike, pastrimi i fshatit nga mbeturinat.

- Shtrimi i sipërfaqes të varrezave pasi po plotësohet ajo aktuale.
- Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fshat mos lejohet të përdorin burimet ujore të zonëssepse banorët që kanë bagëti detyrohen t'i sjellin brenda fshatit për t'i dhënë ujë.

#### **Fshati Qatrom.**

- Asfaltimi i rrugës brenda fshatit.
- Pjesa më e madhe e kanalizimeve janë bërë.
- Këndi sportiv po bëhet, është në proces.

**Fshati Dardhë.** (Nuk ka pjesëmarrës).

**Fshati Ravonik.** . (Nuk ka pjesëmarrës).

**Fshati Moravë.** . (Nuk ka pjesëmarrës).

**Fshati Drenovë.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë kam vetëm mirëmbajtjen e sheshit, nëse keni diçka na thoni.

Kryetari i Fshatit Drenovë: Kanalizimet duan investime sepse kanë probleme, punët e nisura nuk përfundojnë. Duhet zgjerimi i varreve pasi maksimumi dhe 10 vende ka.

Administratori: Është në proces zgjerimi i varreve.

Kryetari i Fshatit Drenovë: Sheshi “Asdreni” nuk ka një përmendore të “Asdrenit” është turp.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E kanë menduar dhe do bëjnë diçka siç i ka hije asaj figure.

Banori: Dua të bëj një falenderim për rehabilitim e sheshit por duhet mirëmbajtur. Unë e kam shtëpinë 200 m larg sheshit dhe gjitha ujërat kur bie shi vijnë tek shtëpia ime, do ju lutem shumë ta furnizionit ndërmarrjen me material për tubo.

Administratori: E kemi dërguar tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për mbushjen e gropave dhe në momentin që do bëhet kjo do bëhet dhe çarja e asfaltit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk jemi specialistë të kësaj fushe, ne do vemë në dijeni drejtorin e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike sepse nuk na takon ne kjo, nuk japim dot zgjidhje teknike.

Banori: Rrugë të tjera brenda fshatit duhen rregulluar, dy janë çakulluar, kanalet e ujërave të zeza janë afër zonave të banimit, duhet bërë edhe pastrimi i ujërave sipërfaqësorë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të ndërhyet tek kanalizimet, në lidhje me ndriçuesat ato tenderohen dhe ndoshta do kohën e duhur, është pjesë e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike.

**Fshati Boboshticë.** (Nuk ka pjesëmarrës).

**Fshati Turan.**

- Probleme me ujin e vaditjes.
- Asfaltimi i rrugës të fshatit.
- Shkolla duhet rikonstruktuar dhe zgjeruar, pasi është e vogël edhe ka fëmijë.
- Kulla e vendosur në qendër të fshatit rrezikon të bjerë.

Kryetari i Fshatit Turan: Kulla rrezikon të bjerë dhe është e rrezikshme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është një projekt i Hënës të Kuqe do bëhet me donatorë.

Administratori: Është nisur një projekt por do skela specifike.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndërtimi i lulishtes në qendër të fshatit, është nisur një projekt për gjitha qendrat e fshatit të gjithë njësisive administrative për rikomozimin e tyre.

Administratori: Na duhet ndihmë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për një tendë për mirëmbajtjen e fshatit.

Kryetari i Fshatit Turan: Varret në pjesën ballore duan kangjella.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ky takim ishte që ne këshilltarët e Bashkisë të dëgjojmë nga ju problematikat kryesore. Ju jeni taksapagues dhe keni të drejtë të kërkonit që çdo gjë të bëhet më mirë. Unë jam i mendimit t'i kërkojmë Bashkisë pak gjëra dhe ato pak të bëhen, mos i kërkojmë shumë dhe mos bëjmë asgjë. Ne si këshilltarë jemi pranë jush dhe do i kërkojmë Bashkisë gjërat primare që ju keni të futen në projektbuxhetin e këtij viti që vjen, faleminderit që ishit pjesëmarrës.

Banori: Në lidhje me taksën e ujit na e dyfishuat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo është pjesë e Ndërmarrjes të Ujësjetës Kanalizimeve.

Banori: Këshilli e miratoi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këshilli e miratoi sepse ndërmarrje bën investime.

Banori: Po nuk ka bërë asgjë, u rrit çmimi 100 % dhe cilësia më keq.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër faleminderit që ishit prezent, ne do jemi pranë jush dhe do jemi zëri juaj.

#### FOTO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12215 Prot.

Datë 19.11.2025

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë

**Z.Sotiraq Filo**

Lenda : Dërgohen për opinion rekomandimet e dhena nga komunitetit gjatë procesit të konsultimit publik

**I nderuar Z. Kryetar !**

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 18 e 54, **Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Ana Verushi, Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare në bashkëpunim me ekzekutivin** realizoi procesin e konsultim publik me komunitetin në përputhje me Rregulloren për Konsultimin Publik, në lidhje me procesin

**“Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026”.**

Po Ju dërgojmë për opinion procesverbalet me cdo rekomandim të dhënë gjatë procesit të konsultimit publik.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur përmbledhjen e rekomandimeve ,

Në pritje të përgjigjes Tuaj se cilat nga këto rekomandime do të përfshihen për financim në plan/buxhetin e vitit 2026.

Lutemi për një përgjigje brenda datës **10.12.2025**.

Me konsideratë,

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

## PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 28 TETOR 2025.

### NJËSIA ADMINISTRATIVE VITHKUQ.

Ora e hapjes së takimit : 15:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Vithkuq.

I mbajtur në datë 28 tetor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketen fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Lubonjë.**

- Investimi tek lumi i lënë përgjysëm.
- Rikonstruksioni i një pjese të rrugës, afërsisht 1 km.
- Probleme me ujësjellës kanalizimet.
- Tjegullat e kishës janë dëmtuar duhen zvendësuar.
- Duhet bërë rruga kryesore.

#### **Fshati Rehovë.**

- Çakullimi i rrugës dhe vendosja e kanaleve anësore të kullimit.

#### **Fshati VITHKUQ.**

- Rregullimi i rrugëve të brendshme, më problematike Lagjia “Dukas”.
- Rregullimi i kalldrëmeve dhe rikonstruksioni i qendrave sportive.
- Probleme me OSHE dhe ujësjellësin.
- Festa e 29 Qershorit të bëhet e përvitshme.

#### **Fshati Shtyllë**

- Pastrimin e lumit dhe mbrojtës anësor.

#### **Fshati Leshnjë**

- Asfaltimi i rrugës të varrezave, vendosja e 4 koshave dhe 4 ndriçues dhe hapja e shtratit të lumit.

## **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 28 TETOR 2025.**

### **NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ.**

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Mollaj.

I mbajtur në datë 28 tetor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Dvoran.**

- Sistemimi i lumit dhe restaurimi i pallateve dy-katëshe.
- Rruga Dvoran- Boboshticë duhet asfaltimi i rrugës.
- Një ambient për moshën e tretë.
- Rruga sipër Dvoranit duhet çakullimi dhe menaxhimi i kanaleve anësore.
- Nuk është bërë kanalizimi i ujërave të zeza tek një lagje.
- Rrethimi i varrezave dhe shtimi i sipërfaqeve për varreza.
- Probleme me ujësjellësin.

#### **Fshati Floq.**

- Asfaltimi i rrugës kryesore dhe sistemi i rrugës të Kishës.

#### **Fshati Kamenicë.**

- Shtrimi me stabilizant i rrugës të varrezave.
- Vendosija e ndriçuesve.
- Vendosija e dy portave tek lumi.

## **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 29 TETOR 2025.**

### **NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË-LEKAS.**

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Voskopojë.

I mbajtur në datë 29 tetor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Voskopojë.**

- 23-24 Qershor aktivitete për çeljen e sezonit turistik.
- Rikonstruksioni i palestrës të shkollës.
- Vendsoja e disa koshave.
- Probleme me ngrohjen e shkollës.
- Vendosja e një banje publike në shesh.
- Shesh vetëm për qëndrimin e autobusave.
- Vend për stalla.
- Palestra e shkollës duhet rikonstruktuar.
- Probleme me ujin e pijshëm.
- Pastrim pyjesh.
- Rikonstruksion i kalldrëmit tek kisha "Shën Ilia".

#### **Fshati Lekas.**

- Rruga e fshatit ka nevojë për asfaltim.

#### **Fshati Lavdar.**

- Krijimi i një qendre shëndetësore.
- Fadromë për hapje kanalesh.
- Asfaltimi i rrugës të fshatit.
- Hapja e një kopështi publik.

#### **Fshati Gjonmadh.**

- Asfaltimi i rrugës.
- Përfundimi i rregullimit të përroit.

#### **Fsahti Lekas.**

- Kërkesë për ndriçues publik.
- Fillimi i punimeve për rrugën e "Denasit".
- Ndërhyrje në përroi.
- Rikonstruksioni i Kishës.

#### **Fshati Shipskë.**

- Çakullimi i rrugës.

### **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 29 TETOR 2025.**

#### **NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOP.**

Ora e hapjes së takimit : 17:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Voskop.

I mbajtur në datë 29 tetor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Voskop.**

- Shtrimi i rrugës të vjetër.
- Shtrimi i rrugës të varrezave.
- Rregullimi i fushës të sportit.
- Ndriçimi i rrugës.

#### **Fshati Dërsnik.**

- Probleme me keqbërësit që dëmtojnë hapësirat publike.
- Zyrë për kryetarin e fshatit.

#### **Fshati Vinçan.**

- Vendosija e disa ndriçuesve dhe koshave të mbeturinave.

#### **Fshati Goskovë e Poshtme.**

- Asfaltimi nga Lavdari, rruga që lidh Goskovën me Vinçanin.
- Në fushën e varrezave të shtrohet rruga, rregullimi i mureve rrethues.
- Probleme me kanalizimin, me kanalet vaditëse dhe probleme me ujin e pijshëm.

#### **Fshati Polenë.**

- Rregullimi i qendrës të fshatit.

- Probleme me ujin e pijshëm.

#### **Fshati Damjanec.**

- Rikonstrukcioni i urës të drurit.

### **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 31 TETOR 2025.**

#### **NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË.**

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek njësia administrative Drenovë.

I mbajtur në datë 31 tetor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Mborje.**

- Kërkesë për përfundimin e rrugëve me kalldrëm të lëna përgjysëm.
- Rikonstrukcioni i çezmës të fshatit.
- Asfaltimi i rrugës nga Lapidari deri tek Kisha e “Ristozit”.
- Pastrimi i fshatit nga mbeturinat sepse makina vjen 1-2 herë në javë.
- Shtrimi i sipërfaqes të varrezave pasi po plotësohet ajo aktuale.
- Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fshat mos lejohet të përdorin burimet ujore të zonës sepse banorët që kanë bagëti detyrohen t’i sjellin brenda fshatit për t’i dhënë ujë.

#### **Fshati Qatrom.**

- Pjesa më e madhe e kanalizimeve janë bërë, të bëhen edhe të tjerat.

#### **Fshati Drenovë.**

- Mirëmbajtja e sheshit.
- Kanalizimet.
- Zgjerimi i varrezave.
- Sheshi i “Asdrenit” duhet një përmendore e Asdrenit.

- Rrugët brenda fshatit duhen rregulluar.
- Probleme me kanalet e ujërave të zeza.
- Pastrimi i ujërave sipërfaqësore.

#### **Fshati Turan.**

- Probleme me ujin e vaditjes.
- Asfaltimi i rrugës të fshatit.
- Shkolla duhet rikonstruktuar dhe zgjeruar, pasi është e vogël edhe ka fëmijë.
- Kulla e vendosur në qendër të fshatit rrezikon të bjerë.
- Varret në pjesën ballore duan kangjella.

### **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 3 NËNTOR 2025.**

#### **NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC.**

Ora e hapjes së takimit : 16:00.

Zhvillimi i takimit: Tek Komuna Bulgarec.

I mbajtur në datë 3 nëntor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

#### **Fshati Bulgarec.**

- Asfaltimi i rrugës të Xhamisë dhe Smt.
- Sistemimi i trotuareve të rrugës të fshatit.
- Ndërtimi i palestrës.
- Rregullimi i rrugës të “Sadikut”.
- Rruga hyrëse është e ngushtë, duhet një pjesë trotuar, të spostohej kanali.

#### **Fshati Çiflig.**

- Shtrimi i rrugës të Manastirit. (Kryetari u shpreh se ishte i gatshëm për ta shtruar).
- Rikonstruksioni i Muzeut.

#### **Fshati Belorta.**

- Asfaltimi i një rruge pasi është lënë përgjysëm.
- Probleme me ujërat e zeza.

- Ndërhyrja tek avllitë e vjetra.

#### **Fshati Malavec.**

- Rikonstruksioni i asfaltit.
- Rruga nga Xhamia deri tek qendra është me asfalt por e amortizuar, duhet ndërhyrë.
- Bordura tek varrezat.

#### **Fshati Lumalas.**

- Asfaltimi i rrugës të fshatit.
- Shtëpitë kur bie shi mbushen me inerte nga guroroja, duhet asfaltimi rrugës.
- Rikonstruksioni i rrugës që lidh Melçanin me Lumalasin.
- Vendosija e dy koshave për mbeturina.

#### **Fshati Dishnicë.**

- Ndriçues publik anësorë.
- Asfaltimi i rrugës poshtë.

#### **Fshati Barç.**

- Asfaltimi i rrugëve të brendshme.

#### **Fshati Kuç i Zi.**

- Duhet bërë asflati tek shkolla.
- Probleme me ujin dhe energjinë.
- Problematike prerja e drurëve.

#### **Fshati Biranj.**

- Shtrimi i rrugës të varrezave.
- Shtrimi i rrugëve me asfalt tek Lagjia e Re.
- Pjesa e asfaltit të bërë nuk ka beton anësor.

### **PROÇESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK DATË 4 NËNTOR 2025.**

#### **RAJONI 1, 2 DHE 3.**

Ora e hapjes së takimit : 18:00.

Zhvillimi i takimit: Tek Bibloteka.

I mbajtur në datë 4 nëntor në lidhje me projekt buxhetin 2026 dhe paketën fiskale. Nga banorët u kërkuan këto investime:

### **Rajoni 1.**

- Teromizilimi i pallateve pasi një pjesë nuk është bërë.
- Prishja e kalldrëmit në lagjet 1,2 nga ndërtimi i palleteve 3-katëshe.
- Lagjia 1, “Viktor Xhika”, Probleme me sistemimin e rreth 30 familjeve që jetojnë në baranga.
- Lagjia 10, tek Enti i Banesave pjesa para pallateve është e pashtuar, ka baltë dhe gropa.
- Rruga “Jorgo Plaku” është një pjesë me shkallë duhet bërë me beton.
- Tek shkolla “Nuçi Naçi” tek pallati 5-katësh ngjitur banorët i kanë blerë materialet duhet bërë termoizolimi me bashkëfinancim.

### **Rajoni 2.**

- Rruga “Nexhip Vinçani” dhe rrugët e lagjeve 14,15,16, rruga “Spiro Kondo” duhen bërë kanalizimet dhe asfaltimet.
- Tek Rruga “Nexhip Vinçani” janë disa gazerma ose të prishen ose t’ju jepet zgjidhje.
- Tek Lagjia 16 duhen bërë kanalizimet.
- Probleme me lagështinë tek 1 pallat lagjia 15.
- Tek lagjia 15 nuk ka 1 qëndër sportive.
- Tek Lagjia 4 duhet një qëndër për pensionistët.
- Tek Fabrika e Birrës mbeturinat janë në trotuare duhet bërë pastrimi.
- Lagjia 16 nuk është asfaltuar asnjë rrugë, kanalizimet janë bërë vetëm në dy rrugë.
- Rregullimi i mureve të spitalit.

### **Rajoni 3.**

- Tek lagjia 6 kanë probleme me asfaltimet.
- Rruga e Ersekës deri tek Shkolla Greke nuk ka ndriçim.
- Mungon sinjalistika rrugore në unazë.
- Lagjia 6 është problem Tregu i Shuleve, Bashkia duhet ta spostojë atë treg.
- Lagjia 8 nuk janë bërë kanalizimet dhe nuk ka ndriçim.
- Lagjet 9 dhe 18 janë të mbipopulluara duhet një çerdhe publike.